

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Mr.sc Muhamet Rexha, antarën, në çështjen juridike të paditësit M. R., nga Peja, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a. me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit dhe pagesën e ndryshimit të pagës, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.1414/2013 datë 27.4.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13 tetor.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pa bazuar revizioni i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1414/2013 datë 27.4.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.1414/2013 datë 27.4.2016, miratohet pjesërisht ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me seli në Prishtinë, dhe priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr. 360/2012 datë 19.3.2013, në pjesën si në pikën I të dispozitivit, me të cilën detyrohet e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 6 dhe 5, për çdo muaj duke filluar nga 1.2.2012 e tutje me kamatë 4%, duke filluar nga data 1.2.,20123 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit ,dhe për këtë pjesë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë nërigjykim, në pjesën si në pikën I të dispozitivit, të të njëjtit aktgjykim me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është bërë anulimi i aktvendimit të paditurës Posta

dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a. me seli në Prishtinë, Nr..., për këtë pjesë ankesa e të paditurës refuzohet si e pa themelët, ndërsa aktgjykimi i atakuar vërtetohet, në pikën II të dispozitivit, aktgjykimi C.nr.360/2012 i datës 19.3.2013 mbetet i pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, në afat ligjor revizion ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në bazë të kontratës së punës me nr..., të datës ..., në cilësinë e punëmarrësit ka themeluar marrëdhënie pune të e paditura në detyrat e punës përgjegjës i postës, njësinë – Posta e Kosovës. Në nenin 5 të kësaj kontrate parashihet që paditësit për punën e kryer t'i kompensohet me pagë të përcaktuar me gradën e 6-të, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-së, Nr..., të dt. ..., së paku një herë në muaj e cila nuk mundet me qenë më pak se paga minimale.

Kryeshefi i PTK-së duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 13.12.2011, me aktvendimin Nr..., të datës ..., paditësit ia ulë lartësinë e gradës prej 6-të në 5-të dhe se ky aktvendim do të konsiderohet pjesë përbërëse e kontratës së punës nr. ..., të datës ..., Kundër aktvendimit të sipërcituar, paditësi ka ushtruar ankesë mirëpo përgjigje nuk ka marrë.

Bordi i Drejtorëve i të paditurës, vendimin e saj e bazon në rekomandimin e aksionarit të PTK-së-Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë për Zhvillim Ekonomik për reduktimin e shpenzimeve operative për personelin e të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave ka gjetur se me nenin 5 të kontratës së punës nr..., të datës ..., lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, ku është

caktuar paga bazë për punën e kryer në lartësi të gradës 6-të dhe nga palët kontraktuese duhet të respektohen dispozitat e kontratës dhe çdo ndryshim i kësaj kontrata ka mund të bëhet vetëm me vullnetin e palëve kontraktues. Pasi që në rast konkret nuk ka një pajtim të tillë, aktvendimi mbi ndryshimin e pagës së paditësit është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës dhe Ligjin e Punës. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrisë për Zhvillim Ekonomik ,nuk ka qenë ulja e pagave të punëtorëve por ulja e shpenzimeve operative për personelin e të paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-së, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka pranuar qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm përkitazi me anulimin e aktvendimit dhe kompensimit të diferencës së pagave , bonusit dhe trustit mes gradës 6 dhe 5, andaj në këtë pjesë ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurës, ndërkaq ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me pagesën e ndryshimit të pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mesë gradës 6 dhe 5, për çdo muaj duke filluar nga data 1.2.2012 e tutje , me kamat 4%.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka pranuar pjesërisht si të pabazuar ankesën e të paditurës.

Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj. Sikurse të dy gjykatat edhe kjo Gjykatë mendon se paditësi ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë në gradën 8-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës dhe dispozitën e nenit 55 par. 1 të Ligjit të Punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 – të RK) ku është përcaktuar se i punësuarit ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Kërkesa e aksionarit-Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së

Zhvillimit Ekonomik, ka qenë që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve operative vjetore të koordinohen konform parametrave të lejuar. Rekomandimi i Ministrisë lidhur me uljen e shpenzimeve operative të e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme, nuk mund të jetë bazë ligjore për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandim nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative duhen të ulën e as që thuhet për uljen e pagave dhe se e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajizuar operativ, në të cilën do të përcaktohej se cilat shpenzime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do të duhej të ishte reduktimi, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur. Përveç kësaj, në shkresat e lëndës nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave të punëtorëve të saj dhe as prova tjera nga të cilat do të rezultonte arsyeshmëria për nxjerrjen e vendimit për uljen e pagës së paditësit.

Parashtrimet në revizion se e paditura ka vepruar në kuadër të qëndrimeve dhe vendimeve të marra nga aksionari i vet-Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ka bërë nivelizimin e pagave në pajtim me vendimin e ligjshëm të këtij organi, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për faktin se Vendimi i Bordit menaxhues nuk përmbajnë referenca ligjore dhe bazë të vlefshme juridike për marrjen e vendimit më të favorshëm për të paditurën ashtu si pa bazë theksohet në revizion.

Qëndron fakti se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë mundë t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka për mes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Parashtrimet në revizion se, aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 182 par 2 pika (n) të LPK-së, kjo Gjykatë i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se aktgjykimet e të dy gjykatave, nuk janë të përfshira me këto shkelje, dispozitivi i aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me arsyetimin, të dy gjykatat kanë vlerësuar faktet relevante për vendosjen e drejtë të kësaj çështjeje juridike lidhur dhe përmbajnë arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet relevante e që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshitë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 204 të LPK-së, pasi që nuk janë vlerësuar pretendimet në ankesë lidhur me afatshmërinë e padisë, kjo Gjykatë i vlerësoi se parashtrimet e tilla nuk përmbajnë bazë të vlefshme juridike për marrjen e vendimit më të favorshëm për të paditurit për faktin se kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i të drejtës në diferencën e pagës, në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë nga se kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të paditurës për zvogëlimin e pagës, për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, afati i parashkrimit është 3 vite e jo siç pretendohet pa bazë në revizion se afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Parashtrimet tjera në revizion kanë të bëjnë me konstatimin faktik dhe qëndrimet juridike të dy gjykatave pa ndikim në vendosjen e meritave të lëndës.

Aktgjykimi i goditur në pjesën që i referohet pagesës së ndryshimit të pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mesë gradës 6 dhe 5 nuk është shqyrtuar pasi që në këtë pjesë aktgjykimi është prishë dhe është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 210/2016, më 13.tetor.2016

**Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani**

